



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 6 qershor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Vërejtje për z. Dastid Pallaska**

---

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të  
Specializuar**

Aleks Uajting

**Mbrojtësit të Viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**

Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**

Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

**TRUPI GJYKUES II** ("Trupi Gjykses"), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullave 63 dhe 116(1) dhe (3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), dhe nenit 13(a) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës, lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 10 maj 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") i kërkoi Trupit Gjykses që t'i tërhiqte vërejtje bashkëmbrojtësit të z. Hashim Thaçi ("z. Thaçi"), zotit Dastid Pallaska ("z. Pallaska"), për deklaratat publike të bëra në emisionin *RTK Prime* më 13 prill 2023 ("Kërkesa").<sup>1</sup>
2. Më 18 maj 2023, pas një kërkesë gojore të Mbrojtjes së z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit"), Trupi Gjykses miratoi shtimin e numrit të lejuar të fjalëve nga 6000 në 7000 fjalë për përgjigjen ndaj Kërkesës.<sup>2</sup>
3. Më 22 maj 2022, Mbrojtja e z. Hashim Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit") iu përgjigj Kërkesës ("Përgjigjja").<sup>3</sup>
4. Më 30 maj 2023, ZPS-ja iu kundërpërgjigj Përgjigjes ("Kundërpërgjigjja").<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> F01515, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për Vërejtje për z. Dastid Pallaska*, 10 maj 2023, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.

<sup>2</sup> Transkripti i seancës, 18 maj 2023, publik, f. 4389, rreshtat 4-11.

<sup>3</sup> F01541, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Vërejtje për z. Dastid Pallaska*, 22 maj 2023, me Shtojcën 1.

<sup>4</sup> F01561, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Thaçit ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Vërejtje për z. Dastid Pallaska*, 30 maj 2023.

## II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja parashtron se deklaratat publike të z. Pallaska në emisionin *RTK Prime* më 13 prill 2023 ("Deklaratat në RTK"), bien ndesh me nenin 13(a) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës<sup>5</sup> ("Kodi i Etikës") dhe me paragrafët 15-20 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit<sup>6</sup> të Trupit Gjykses, të cilat ndalojnë bërjen e deklaratave të rreme, qëllimisht çorientuese, ose që përmbajnë komente në lidhje me kërkesat të cilat janë aktualisht në proces shqyrtimi nga Trupi Gjykses.<sup>7</sup> Për këtë arsye, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses t'i rikujtojë z. Pallaska që të respektojë kushtet e nenit 13(a) të Kodit të Etikës si dhe udhëzimet që përmban Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit i Trupit Gjykses, dhe në të ardhmen të mos bëjë deklaratë që i shkelin ato, pasi deklarata të tilla kanë një ndikim negativ në integritetin e procesit. ZPS-ja gjithashtu kërkon që z. Pallaska të paralajmërohet se çdo shkelje e Kodit të Etikës ose e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit në të ardhmen mund të çojë në marrjen e masave.<sup>8</sup>

6. Mbrojtja e Thaçit përgjigjet se Kërkesa bazohet në shtrembërime që ZPS-ja u bën komenteve të z. Pallaska dhe se reputacioni i z. Pallaska nuk duhet të dëmtohet publikisht nga manipulimi që ZPS-ja u bën fjalëve të tij.<sup>9</sup>

7. ZPS-ja kundërpërgjigjet se: (i) asnjë nga arsyet e paraqitura nga Mbrojtja e Thaçit nuk e ndryshon faktin që z. Pallaska bëri deklarata publike për të cilat, sipas cilitdo vlerësimi objektiv, ai ishte i vetëdijshtëm se ishin të rreme dhe/ose

---

<sup>5</sup> Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-07-Rev1, 28 prill 2021.

<sup>6</sup> F01226, Trupi Gjykses, *Urdhër mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, me Shtojcën 1 ("Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit").

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 2, 4-6, 9. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Kërkesës.

<sup>8</sup> Kërkesa, para. 3, 16, 20, 22.

<sup>9</sup> Përgjigjja, para. 1, 5, 36.

çorientuese në ato rrethana; dhe se (ii) vërejtja është masa e duhur që duhet të caktojë Trupi Gjykses.<sup>10</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Sipas nenit 40(2), Trupi Gjykses siguron që shqyrtimi gjyqsor të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procedurat të zhvillohen në pajtim me Rregulloren e Procedurës dhe Provave, në respekt të plotë të të drejtave të të akuzuarit dhe duke i kushtuar kujdesin e duhur mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve. Në bazë të nenit 40(2) dhe rregullës 116(3), Trupi Gjykses mund të japë udhëzime të nevojshme për kryerjen e procedurave që garantojnë një gjykim të drejtë dhe të shpejtë. Trupi Gjykses e ka shfrytëzuar këtë mundësi, e cila rregullon zhvillimin e procesit gjyqsor, edhe në lidhje me deklaratat që mbrojtësi mund të bëjë për mediat.<sup>11</sup>

9. Sipas rregullës 63, Trupi Gjykses mund t'i tërheqë vërejtje mbrojtësit ose prokurorit për sjellje që janë fyese, shpërdoruese ose ndryshe pengojnë zhvillimin e duhur të procesit, ose në qoftë se mbrojtësi ose prokurori nuk përmbush normat e etikës profesionale në ushtrimin e detyrave.

10. Neni 13(a) i Kodit të Etikës Profesionale përcakton se mbrojtësit dhe prokurorët nuk duhet që me vetëdije të bëjnë në media sociale, shtyp apo publikisht deklarata të rreme ose shpifëse, apo të nxjerrin informacione konfidenciale, ndër të cilat informacione për persona të përfshirë në procese gjyqsore.

---

<sup>10</sup> Kundërpërgjigjja, para. 8.

<sup>11</sup> Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 15-20.

#### IV. DISKUTIM

11. Në lidhje me Deklaratat në RTK, ZPS-ja parashtron se z. Pallaska: (i) ka bërë me vetëdije deklarata çorientuese;<sup>12</sup> dhe (ii) ka komentuar debatimet juridike në zhvillim e sipër para Trupit Gjykses.<sup>13</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendon se Deklaratat në RTK nuk janë të mëvetshme, por pjesë e një praktike shqetësuese sjelljeje të z. Pallaska.<sup>14</sup> Rrjedhimisht, ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses duhet t'i tërheqë vërejtje z. Pallaska.<sup>15</sup>

12. Mbrojtja e Thaçit përgjigjet se: (i) pretendimi i ZPS-së se z. Pallaska "akuzo[i] publikisht Prokurorinë se përhap 'të pavërteta', me qëllim që ta etiketojë Kosovën si shtet kriminal" shtrembëron komentet e z. Pallaska;<sup>16</sup> (ii) komentet e z. Pallaska thjesht përsërisin qëndrimet e mirënjohura të Mbrojtjes për aspekte që janë pjesë e argumenteve mbrojtëse të z. Thaçi;<sup>17</sup> (iii) z. Pallaska nuk ka komentuar debatimet juridike në zhvillim e sipër para Trupit Gjykses;<sup>18</sup> dhe se (iv) ZPS-ja nuk e ka arsyetuar kërkesën e vet për kufizimin e të drejtave themelore të z. Thaçi dhe avokatëve të tij.<sup>19</sup>

13. ZPS-ja kundërpërgjigjet se: (i) një mbrojtës i emëruar, që ka detyrimin, ndër të tjera, të sinqeritetit dhe zellit, nuk mund të bazohet në padijeni, për t'i ikur përgjegjësisë për deklaratat e veta publike; dhe (ii) artikulli i qëndrimeve të Mbrojtjes në publik nuk e liron mbrojtësin nga detyrimi i respektimit të nenit 13(a) të Kodit të Etikës dhe Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit.<sup>20</sup>

14. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se roli i z. Pallaska si bashkëmbrojtës i z. Thaçi nuk rezulton në shtypjen e të drejtës së lirisë së fjalës, të cilën ai vazhdon ta

---

<sup>12</sup> Kërkesa, para. 7-9.

<sup>13</sup> Kërkesa, para. 10-15.

<sup>14</sup> Kërkesa, para. 18-19. *Shih gjithashtu* Shtojca 2 e Kërkesës.

<sup>15</sup> Kërkesa, para. 16-17, 20.

<sup>16</sup> Përgjigja, para. 8, *ku citohet* Kërkesa, para. 9. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 9-20.

<sup>17</sup> Përgjigja, para. 2, 21-25.

<sup>18</sup> Përgjigja, para. 26-33.

<sup>19</sup> Përgjigja, para. 34-35.

<sup>20</sup> Kundërpërgjigja, para. 1-7.

gëzojë.<sup>21</sup> Sidoqoftë, përfshirja e tij si avokat mbrojtës në këtë proces gjyqësor autorizon vendosjen e kufizimeve mbi këtë të drejtë për aq sa ato janë të domosdoshme dhe proporcionale, për të garantuar mbrojtjen e interesave të tjera legjitime publike dhe për aq sa ato janë në përputhje me standardet ligjore përkatëse të zbatueshme për këtë aspekt.

15. Trupi Gjyqësor vëren se puna e Dhomave të Specializuara ("DHS") është çështje me interes publik në Kosovë. Trupi Gjyqësor gjithashtu gjykon se avokatët kanë një rol të rëndësishëm në administrimin e drejtësisë si ndërmjetësues ndërmjet publikut dhe gjykatave.<sup>22</sup> Ata që emërohen si mbrojtës para DHS-së kanë përgjegjësinë e veçantë për të siguruar që debatimet juridike të bëhen vetëm para Trupit Gjyqësor përkatës, dhe që të mos bëhen debaime të tjera anësore përmes mediave. Ata gjithashtu duhet të mos bëjnë me vetëdije deklarata në mediat sociale, shtyp apo publikisht, të cilat janë të rreme ose shpifëse, apo të nxjerrin informacione konfidenciale, ndër të cilat informacione për persona të përfshirë në procese gjyqësore. Trupi Gjyqësor është i mendimit se komentet e z. Pallaska mbi juridiksionin e DHS-së dhe kuadrin e akuzave të ZPS-së, ndonëse shpesh të pambështetura në informacion dhe të pasakta,<sup>23</sup> përbëjnë opinione personale që trajtojnë aspekte të përzgjedhura që i janë paraqitur DHS-së në të kaluarën, dhe jo komente çorientuese mbi aspekte të veçanta që po shqyrtohen aktualisht nga Trupi Gjyqësor. Në mënyrë të ngjashme, deklaratat e z. Pallaska për disa kategori të provave, për masat mbrojtëse dhe për vazhdimin e paraburgimit janë abstrakte dhe jo mjaftueshëm konkrete për t'u cilësuar si një praktikë komentesh mbi debatimet juridike në zhvillim e sipër para Trupit Gjyqësor.

---

<sup>21</sup> ECtHR, *Morice v. France*, Judgment [GC] ("[Morice Judgment](#)"), 23 April 2015, para. 134-135; *Mor v. France*, Judgment ("[Mor Judgment](#)"), 15 December 2011, para. 41-44; *Amihalachioaie v. Moldova*, Judgment ("[Amihalachioaie Judgment](#)"), 20 April 2004, para. 27-28.

<sup>22</sup> *Shih gjithashtu* ECtHR, [Morice Judgment](#), para. 132-133; [Mor Judgment](#), para. 43-44; [Amihalachioaie Judgment](#), para. 27-28; *Casado Coca v. Spain*, [Judgment](#), 24 February 1994, para. 54.

<sup>23</sup> *Shih* më poshtë, para. 18.

17. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Deklaratat në RTK: (i) nuk përbëjnë një përpjekje për të çorientuar, në mënyrë të vetëdijshme, publikun, apo për të ndikuar në vendimet e Trupit Gjykses; dhe (ii) me to nuk është nxjerrë informacion konfidencial. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses gjykon se ZPS-ja nuk ka arritur të provojë se në këto rrethana është e domosdoshme t'i tërhiqet vërejtje z. Pallaska dhe se kjo do të përbënte një ndërhyrje proporcionale në të drejtën e lirisë së fjalës të z. Pallaska. Për këto arsye, Trupi Gjykses hedh poshtë kërkesën e ZPS-së për vërejtje për z. Pallaska.

18. Pavarësisht nga kjo, në lidhje me deklaratën e z. Pallaska se në këtë çështje gjyqësore po gjykohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës ("UÇK") dhe se qëllimi i ZPS-së është ta shpallë Kosovën shtet kriminal,<sup>24</sup> Trupi Gjykses thekson se: (i) ZPS-ja ka deklaruar se "këtu nuk është në gjykim UÇK-ja. Lufta çlirimtare e realizuar nga UÇK-ja nuk është në gjykim";<sup>25</sup> (ii) Trupi Gjykses ka deklaruar se "ky Trup Gjykses dhe palët do të merren vetëm me ngjarjet dhe rrethanat që kanë të bëjnë me të akuzuarit që janë këtu";<sup>26</sup> dhe se (iii) për asnjë pjesë të Aktakuzës nuk ka arsye të besohet se sugjeron se po gjykohet UÇK-ja ose Kosova në tërësi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses udhëzon mbrojtësin e z. Thaçi të informojë z. Pallaska për deklaratat e ZPS-së dhe të Trupit Gjykses në lidhje me kuadrin e Aktakuzës. Trupi Gjykses thekson dhe rithekson se pikat që kontestohen në këtë çështje gjyqësore duhet të debatohen nga mbrojtësit e të akuzuarve dhe ZPS-ja vetëm para Trupit Gjykses dhe jo në media. Çdo deklaratë të mëtejshme publike të mbrojtësit që sugjeron se në këtë çështje gjyqësore po gjykohet UÇK-ja, Trupi Gjykses do ta konsiderojë si të bërë me vetëdije në kundërshtim me deklaratat gjyqësore për të kundërtën. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se është përgjegjësi e secilit mbrojtës që t'u kujtojë bashkëmbrojtësve dhe anëtarëve të tjerë të ekipit

<sup>24</sup> Shtojca 1 e Kërkesës, f. 10, 18. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 3, 8-20.

<sup>25</sup> Transkripti i seancës, 3 prill 2023, publik, f. 2246, rreshtat 17-21. *Shih gjithashtu* Transkriptin e seancës, 3 prill 2023, publik, f. 2195, rreshtat 9-12.

<sup>26</sup> Transkripti i seancës, 16 dhjetor 2022, publik, f. 1726, rreshtat 5-6.

detyrimet e tyre sipas Kodit të Etikës dhe Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit, dhe t'i paralajmërojë kur është e duhur, pa ndërhyrje gjyqësore.

## V. VENDIM

19. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **HEDH POSHTË** Kërkesën;
- b) **UDHËZON** mbrojtësin e z. Thaçi ta informojë z. Pallaska për këtë vendim; dhe
- c) **UDHËZON** mbrojtësin t'u kujtojë bashkëmbrojtësve dhe anëtarëve të tjerë të ekipit detyrimet e tyre sipas Kodit të Etikës dhe Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit, dhe t'i paralajmërojë kur është e nevojshme.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**

**Kryegjykatës**

E martë, 6 qershor 2023

Në Hagë, Holandë.